

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ujësjesit përmirësojnë financat, por 53% e shoqërive nuk mbulojnë kostot operative
ADRESA	https://versus.al/ekonomi-mjedis/ujesjesit-permiresojne-financat-por-53-e-shoqerive-n-uk-mbulojn-i46619
BURIMI	versus.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 06:24:01 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 06:02:59 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	724b9d426191b9ec4c5ebccd6b964b6955c8d6f33ff73ca7e4908527678dd2a3
TEKSTI	56ee989404b354875a80a10c16687f7a5d175a4d2ec19bf859ea83828c9af700
PAMJA	4d20f21a921bf8b70d4a0b968a247797be00409baee0ef75ffdb781ee209a5e6

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	acb73fa8c7f51817008398bf54e5da83e20edced940f22d2d421e427484f545f
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	985910a8b149f05aa8f3bf8ae89976932fafb83b0b40b51f12f3baea4334fc12
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/acb73fa8c7f51817008398bf54e5da83e20edced940f22d2d421e427484f545f>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



BOTA

[Kosova pret në shesh bijtë e saj, sot në Hagë gjykata jep vendimin për 4 ish-krerët e UÇK](#)

16 Shtator 2026, 08:08

^ekstrakti^

Na ndiqni edhe në

-
-
-
-
- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZInë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [Ekonomi](#)
- [ZANAT](#)
- [VIDEO](#)

Kërko

-
-
-
-
- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZInë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [ekonomi & MJEDIS](#)
- [VIDEO](#)

Created and monetized by
[EKONOMI & MJEDIS](#) / 16 Shtator 2026, 08:02

Ujësjetllësit përmirësojnë financat, por 53% e shoqërive nuk mbulojnë kostot operative



Shkruar nga Versus





Sektori i ujësjellës-kanalizimeve ka përmirësuar treguesit financiarë gjatë vitit 2025, me rritje të aftësisë për të mbuluar kostot e aktivitetit, por më shumë se gjysma e operatorëve vijojnë të mos arrijnë të financojnë nga të ardhurat e tyre kostot e operimit dhe mirëmbajtjes.

Sipas Raportit të Performancës 2025 të Entit Rregullator të Ujit (ERRU), mbulimi i kostove të operimit dhe mirëmbajtjes (O&M) arriti në 116.8%, niveli më i lartë i regjistruar deri tani, nga 107.6% një vit më parë.

Ndërkohë, mbulimi i kostos totale u rrit në 89%, nga 83.2% në vitin 2024. ERRU vlerëson se këto rezultate reflektojnë përmirësimin gradual të qëndrueshmërisë financiare të sektorit, por mbulimi i plotë i kostove mbetet ende një objektiv për t'u arritur.

Përmirësimi i treguesve financiarë u mbështet nga rritja e të ardhurave të gjeneruara nga aktiviteti. Gjatë vitit 2025, të ardhurat e shoqërive ujësjellës-kanalizime u rritën me rreth 1 miliard lekë ose 9%, një rritje më e lartë se rritja e kostove. Sipas raportit, "raporti ndërmjet të ardhurave dhe kostove u përmirësua, duke ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e treguesve të mbulimit të kostove".

Ajo që bie në sy është se përmirësimi i sektorit në nivel kombëtar nuk është i njëjtë për të gjithë operatorët. Nga 17 shoqëri që operuan gjatë vitit 2025, vetëm 8 arritën të mbulojnë kostot O&M, ndërsa 9 shoqëri ose 53% e totalit vijuan të mos i mbulojnë këto kosto.

Raporti i ERRU-së evidenton se rezultatet e operatorëve më të mëdhenj kanë ndikim të rëndësishëm në performancën e përgjithshme të sektorit. "Performanca financiare e sektorit vijon të ndikohet në masë të konsiderueshme nga rezultatet e operatorëve me peshën më të madhe në sektor", thuhet në dokument.

Kostot totale të aktivitetit të shoqërive ujësjellës-kanalizime arritën në rreth 13.92 miliardë lekë në vitin 2025, nga 13.67 miliardë lekë një vit më parë, duke shënuar një rritje prej rreth 2%. Rritja u ndikua kryesisht nga shtimi i kostove të amortizimit, provizioneve, kostove financiare dhe zërave të tjerë të lidhur me aktivitetin.

Një nga zërat kryesorë që ka ndikuar në kostot operative ishte puna. Sipas raportit, kostoja e punës u rrit me rreth 245.6 milionë lekë, duke arritur në 6.1 miliardë lekë në vitin 2025.

Kjo ndodhi edhe pse numri i punonjësve në sektor u ul në 7,468 persona, nga 7,616 një vit më parë. ERRU shpjegon se rritja e kostove lidhet kryesisht me "ndryshimet në pagën bazë minimale në shkallë vendi, si dhe me rritjen e pagave për kategori të ndryshme punonjësish, veçanërisht të stafit administrativ".

Edhe energjia elektrike vijon të jetë një nga kostot kryesore për operatorët. Në vitin 2025, shpenzimet për energjinë u rritën me rreth 85.8 milionë lekë ose 3.5%, duke përbërë rreth 24% të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes./ **Monitor.al**

Tags:

[ujësjelles](#)

Poll




EKONOMI & MJEDIS

[Shkëmë mashtrimi me faturat në transportin rrugor, zbulohet evazion fiskal prej 6 milionë eurosh](#)

15 Shtator 2026, 19:09

^ekstrakti^





EKONOMI & MJEDIS

[**Bonusi i pensionistëve, Ibrahimaj: Do të dyfshohet nga 1 janari 2027**](#)

15 Shtator 2026, 17:18

^ekstrakti^



EKONOMI & MJEDIS

[**VIDEO/ Nis ndërtimi i bajpasit të Elbasanit, Karakaçi: Segmenti i parë, autostradë e kategorisë A**](#)

15 Shtator 2026, 17:11

^ekstrakti^



EKONOMI & MJEDIS

[**Fuqi e ulët blerëse, nafta në Shqipëri kushton 2.6 herë më shumë se mesatarja e gjithë Europës**](#)

15 Shtator 2026, 08:14

^ekstrakti^



EKONOMI & MJEDIS

[Nafta në Shqipëri 45% më e shtrenjtë se në rajon, shkak taksat](#)

14 Shtator 2026, 19:05

^ekstrakti^



EKONOMI & MJEDIS

[35.3 miliardë lekë pasuri të konfiskuara të krimit, në 8 muaj 180 mln lekë nga qiratë e administruar nga shteti](#)

14 Shtator 2026, 18:22

^ekstrakti^



EKONOMI & MJEDIS

[Euro e nis edhe këtë javë në rënie, prek nivelin më të ulët historik me lekun shqiptar](#)

14 Shtator 2026, 13:23

^ekstrakti^



EKONOMI & MJEDIS

[BE ka dhënë 1.1 milionë leje qëndrimi për shqiptarët, në Gjermani numri arrin rekordin e 124 mijë](#)

14 Shtator 2026, 08:04

^ekstrakti^

[Të fundit](#)





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.